



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4777 Prot.

Fushë-Arrëz, më 27.12.2024

VENDIM
Nr. 62, datë 23.12.2024

MBI MIRATIMIN E OBJEKTEVE PRIORITARE PËR INVESTIME PËR VITIN 2025 E NË VAZHDIM

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 15 pika 1, neni 16 pika 1, neni 23 pikat 1,2,3,4,5,9,11,13,14, neni 27 pika 1 dhe 5, neni 55 pika 2 dhe 6, neni 64 pika "c", neni 66 pika "e", ligjin Nr 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", neni 21, ligjin Nr 115/2014 date 31/07/2014 "Për Ndarjen Administrative Territoriale", VKM Nr. 1096 datë 28.12.2015 "Për Miratimin e Rregullave , Kushteve, Proçedurave për Përdorimin dhe Menaxhimin e Hapësirave Publike", neni 7, Ligjin Nr 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, neni 53,
Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 23.12.2024 ,pas diskutimeve:

VENDOSI:

1. Miratimin e objekteve prioritare për investime për vitin 2025 e në vazhdim, sipas listës bashkëlidhur projekt vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe e Shërbimit Pyjor, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe i Financës, Bordi i Kullimit dhe Shërbimi Zjarrfikës dhe Shpëtimit.

Ky vendim u miratua me :

11 Vota pro

0 Vota kundër

0 Vota abstenim

Vendimi u zbardh me datë, 27.12.2024

KRYETARI

Nikolin BARDHOKU



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al

Faqe 1 në 1